



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 560 Prot.

Tiranë, më datë 18.04 2023

VENDIM  
Nr. 166, datë 18.04.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 18.04.2023:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për Projektin “Rijetësim dhe ndryshim funksioni në hoteleri në objekt ekzistues 3 kat, me pronar dhe investitor Nadire Ismail Kasa dhe Abaz Tare Kasa, Lagjja Kala, Elbasan”, Brenda kufirit Zone Arkeologjike ‘A’ dhe brenda kufirit të Kalasë së Elbasanit, me aplikues Gëzim Kalija dhe zhvillues Nedire Kasa;
  - Të plotësohet projekti me të gjithë elementët e nevojshëm teknik dhe ligjore (të saktësohen planimetritë, prerjet dhe fasadat teknike);
  - Ndërhyrjet duhet të jenë të karakterit restaurues në përputhje me vlerat arkitekturore të ansamblit;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Klesta QIRICI

